



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

Akademia e Kosovës për Siguri Publike

Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost / Kosovo Academy for Public Safety

POLITIKAT E BASHKËPUNIMIT DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

Divizioni për Marrëdhënie me Jashtë
Vushtrri, 2024

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE DHE SQARIMI I TERMAVE.....	3
1. Qëllimi dhe objektivat e politikave për marrëdhënie me jashtë.....	4
1.1 Qëllimi	4
1.2 Objektivat.....	5
2. Fushëveprimtaria e bashkëpunimit	6
3. Palët kyçe të interesit	7
4. Parimet dhe standardet	8
5. Llojet e aktiviteteve	8
6. Zhvillimi i partneritetit	9
7. Përgjegjësitë institucionale.....	10
8. Financimi dhe burimet.....	10
9. Monitorimi, vlerësimi dhe raportimi.....	11
10. Menaxhimi i riskut.....	11
11. Komunikimi dhe dukshmëria.....	13
12. Përputhshmëria me strategjitë kombëtare dhe ndërkombëtare.....	13
13. Tabela për detajet e rishikimit të politikave të bashkëpunimit dhe marrëdhënieve me jashtë.....	14
SHTOJCAT	
13. Përcaktimi i objektivave të planit të punës së DMJ-së.....	15
14. Plani i veprimit për 2024.....	16

LISTA E SHKURTESAVE DHE SQARIMI I TERMAVE

AKSP	Akademia e Kosovës për Siguri Publike
AKA	Agjencia e Kosovës për Akreditim
AKK	Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
FSP	Fakulteti i Sigurisë Publike
ICITAP	Programi i Asistencës së Trajnimit Ndërkombëtar të Hetimeve Kriminale
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
BE	Bashkimi Evropian
ISP	Institucionet e Sigurisë Publike që veprojnë në AKSP
PK	Policia e Kosovës
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
AME	Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave
SHKK	Shërbimi Korrektues i Kosovës
SHSK	Shërbimi Sprovues i Kosovës
DK	Dogana e Kosovës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
Palët e interesit	Institucionet e Sigurisë Publike, duke mos u kufizuar vetëm në: Policia e Kosovës (PK), Dogana e Kosovës (DK), Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK), Shërbimi Sprovues i Kosovës (SHSK), Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) dhe Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME)
Vijues	Personat të cilët vijnë trajnime dhe arsim të lartë në Akademi
IADLEST	Asociacioni Ndërkombëtar i Drejtorëve të Standardeve dhe Trajnimit të Zbatimit të Ligjit
Partnerët ndërkombëtarë	Partnerët që veprojnë dhe bashkëpunojnë dhe e përkrahin AKSP-në, si ICITAP, OSBE, BE, institucionet përkatëse vendore dhe ndërkombëtare të trajnimit dhe arsimit të lartë në fushën e sigurisë publike

1. Qëllimi dhe objektivat e politikave për marrëdhënie me jashtë

1.1 Qëllimi

Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me jashtë janë pjesë qenësore e funksionimit të gjithëmbarshtëm të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike (AKSP). Përmes tyre arrihet që cilësia, niveli dhe standardet e trajnimit dhe arsimit në siguri publike në Kosovë të jenë të barabarta me ato ndërkombëtare, veçanërisht të Bashkimit Evropian (BE) dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA). Për më tepër, përmes përfshirjes të sa më shumë zyrtarëve të sigurisë publike të Kosovës nga AKSP-ja arrihet që Kosova në fushën e zbatimit të ligjit të jetë në hap me zhvillimet bashkëkohore, duke ndikuar kështu që të lehtësohet dhe shpejtohet integrimi i saj në mekanizmat euro-atlantikë nga kjo fushë.

Ngritja e kapaciteteve profesionale dhe institucionale në të gjitha aspektet, e me theks të veçantë trajnimi dhe arsimimi i zbatuesve të ligjit si faktor kyç në ngritjen e sigurisë publike, është sfidë me shumë dimensionë. Prandaj, bashkëpunimi me të gjithë akterët relevantë vendorë dhe ndërkombëtarë brenda dhe jashtë vendit në fushën e arsimit në siguri publike është thelbësor për të adresuar në vazhdimësi dhe me kohë sfidat aktuale dhe për të siguruar që të gjithë akterët relevantë, respektivisht vijuesit e trajnimeve, studentët, profesionistët, stafi i Akademisë dhe i palëve të interesit (të ISP-ve) që përmes trajnimeve dhe studimeve të marrin njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë e duhura me cilësi të lartë dhe sipas standardeve më të larta (të krahasueshme dhe të njohura ndërkombëtarisht).

Ngritja e cilësisë së trajnimeve dhe të arsimit të lartë, ndër të tjera, arrihet edhe përmes shkëmbimit të njohurisë dhe përvojave. Për këtë arsye, për AKSP-në është e rëndësishë jashtëzakonisht të madhe që të arrijë të shkëmbejë vijuesit e aktiviteteteve të ngritjes së kapaciteteve (kadetët, vijuesit e trajnimeve, studentët), mësimdhënësit (trajnerët, instruktorët dhe ligjëruesit) si dhe zyrtarët e administratës që kanë të bëjnë me mësimdhënien dhe mësimnxënien.

Përkrahja e ndërtimit të kapaciteteve në AKSP arrihet gjithmonë përmes partneritetit ndërkombëtar, duke përfshirë miqtë dhe aleatët e Kosovës edhe në nivel kombëtar, siç janë kryesisht shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe vendet tjera pro-perëndimore. Në këtë mënyrë, përmes dy projekteve të binjakëzimit të financuar nga BE-ja, përkatësisht “Përmirësimi i Arsimit në Sektorët e Rendit dhe Sigurisë Publike në Kosovë” (2012 - 2014) dhe “Përkrahja e Mëtejme për Arsim në Siguri Publike në Kosovë” (2016 - 2019), përmes AKSP-së, të përkrahur nga institucionet e sigurisë publike dhe partnerët tjerë ndërkombëtarë, Kosova ka arritur që të validojë dhe akreditojë kurrikulat e trajnimeve profesionale dhe të arsimit të lartë, duke përfshirë dhe vet themelimin e Fakultetit të Sigurisë Publike (FSP) të AKSP-së.

Përmes formalizimit të bashkëpunimit me pothuajse të gjitha institucionet e ngjashme në rajonin e Ballkanit Perëndimor, si ato të Shqipërisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut, AKSP ka arritur që të njihet në regjion si institucion publik cilësor që ofron trajnime, arsim të lartë dhe hulumtim. Ky bashkëpunim mëtohet që në të ardhmen të ngritet dhe intensifikohet, duke arritur kështu integrimin sa më të lartë të arsimit në siguri publike në aspektin rajonal.

Për më tepër, AKSP gjithmonë ka pasur për qëllim që përmes akreditimeve vendore dhe ndërkombëtare të arrijë nivelet dhe standardet më të larta në fushën e sigurimit të cilësisë, duke i përshtatur ato me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEK). Kjo është arritur përmes validimit kombëtar të kurrikulave të trajnimeve vendore, akreditimit të programit të arsimit të lartë, por edhe njohjes ndërkombëtare duke u akredituar për 3 herë, dy herët e fundit prej të cilave

me “Çmimin e Ekselencës” nga Asociacioni Ndërkombëtar i Drejtorëve të Standardeve dhe Trajnimit të Zbatimit të Ligjit (IADLEST). Për më tepër, që nga 24 marsi 2017, AKSP shërben si Pikë Kombëtare Kontakti e Agjencisë së Bashkimit Evropian për Trajnim në Zbatimin e Ligjit (CEPOL), duke mundësuar kështu që zyrtarët e zbatimit të ligjit nga Kosova të i ngrisin kapacitetet e tyre profesionale përmes shkëmbimit të përvojave, përmes pjesëmarrjes nëpër aktivitete të trajnimeve, dhe aktiviteteve të tjera arsimore dhe hulumtuese, të jenë të azhurnuar me njohuri dhe përvoja të reja në raport me zhvillimet e fundit nga kjo fushë në shtetet anëtare të BE-së.

1.2 Objektivat

Në kuadër të ndërkombëtarizimit, DMJ ka përcaktuar objektivat e saj me të cilat synon përkrahjen e vazhdueshme në mbarëvajtjen dhe vazhdimin e bashkëpunimit të AKSP-së me institucionet përkatëse ndërkombëtare me të cilat ka bashkëpunim dhe në të njëjtën kohë në zgjerimin e bashkëpunimit me institucione dhe mekanizma të tjerë ndërkombëtarë. AKSP po ashtu synon ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe institucionale, avancimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të trajnimeve, arsimit të lartë dhe profilit hulumtues në siguri publike, identifikimin dhe përfitimin nga programet dhe projektet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, identifikimin e donacioneve të mundshme si dhe rritjen e kredibilitetit profesional dhe institucional në nivel vendor dhe ndërkombëtar.

Në kuadër të përkrahjes së zbatimit të misionit dhe vizionit të AKSP-së, DMJ e ka të përcaktuar objektivin strategjik gjithëpërfshirës “Zhvillimi i mëtejshëm i bashkëpunimit me palët e interesit vendore dhe ndërkombëtare” që është i përfshirë në Strategjinë Zhvillimore të AKSP-së 2023 - 2026. Në zbatimin e politikave të DMJ-së, ky objektiv strategjik më pastaj zbërthehet më tutje në objektivat e tjerë specifike dhe aktivitete:

- **Fuqizimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit vendor dhe ndërkombëtar** - Me këtë veçanërisht nënkuptohet qëllimi i DMJ-së për:
 - **Zhvillimin e vazhdueshëm, mirëmbajtjen dhe avancimin e partneritetit me institucione dhe mekanizma të ndryshëm vendorë dhe ndërkombëtarë** brenda dhe jashtë vendit, me të cilat tashmë bashkëpunojmë apo janë krijuar kontaktet e para, si dhe krijimin dhe zhvillimin e partneritetit dhe bashkëpunimit krejtësisht të ri.
 - **Nënshkrimin e marrëveshjeve vendore dhe ndërkombëtare:** Mirëmbajtja dhe zbatimi i marrëveshjeve në fuqi, dhe synimi për nënshkrimin e marrëveshjeve të reja siç janë ato të iniciativave të radhës me institucionet përkatëse nga Bullgaria, Franca dhe Turqia.
 - **Identifikimin e partnerëve vendorë dhe ndërkombëtarë:** Varësisht prej sferave të interesit të AKSP-së apo sferave të interesit të përbashkët, identifikohen partnerët, hartohen kërkesat dhe adresohen drejt ato kërkesa.
 - **Përfitimin nga programet dhe projektet e ndryshme** (përmes fondeve të huaja dhe atyre vetanake) **në përkrahje të ngritjes së kapaciteteve institucionale dhe profesionale:** mirëmbajtja dhe zbatimi i projekteve në fuqi dhe aplikimi për programe e projekte të reja, me theks të veçantë, por pa u kufizuar në: CEPOL, Erasmus+, marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale, Programin Fullbright, fondet e ndryshme të BE-së, SHBA-së, etj. Këtu përfshihen edhe hapat si: hartimi i kërkesave për mbështetje nga donatorët dhe identifikimi i donatorëve të mundshëm.

- **Rritja e kredibilitetit të AKSP** nga aspekti i transparencës dhe besueshmërisë, përmes:
- **Njohjes ndërkombëtare të vlerave dhe stadarëve të arritura institucionale, profesionale dhe programeve** (të trajnimeve dhe arsimit të lartë), si dhe të proceseve të akreditimeve vendore dhe ndërkombëtare;
 - **Pjesëmarrjes në projekte të ndryshme në partneritet me institucionet përkatëse ndërkombëtare**, si: programe shkëmbimi (mobilitetesh), projekte hulumtuese, etj.;
 - **Promovimit dhe inkurajimit të personelit dhe studentëve të AKSP-së**, si dhe zyrtarëve të sigurisë publike **për pjesëmarrje në programe të mobilitetit**;
 - **Pjesëmarrjes dhe organizimit të konferencave, seminareve dhe ngjarjeve të tjera shkencore dhe profesionale** me kredibilitet dhe karakter vendor dhe ndërkombëtar.

Konkretizimi i kësaj që u përmend më sipër qoftë në aspektin kohor afatshkurtër, afatmesëm apo afatgjatë, varet nga shumë faktorë të brendshëm dhe të jashtëm, duke përfshirë dhe nga harmonizimin e tyre, ku AKSP ka rol kyç. Përveç kësaj, kjo varet edhe prej udhëheqjes së politikave të vet institucionit, bashkëpunimit me të gjithë akterët relevantë, koordinimit, zbatimit, mbikëqyrjes, monitorimit dhe vlerësimit, që kanë për qëllim përmirësimin e vazhdueshëm kundrejt sfidave dhe trendeve të kohës në fushën e trajnimit dhe arsimit (duke përfshirë hulumtimin) në siguri publike.

Në kuadër të politikave sektoriale (DMJ-së) mbi realizimin sa më të sukseshëm të të lartëcekurave, përveç hartimit të objektivave dhe aktiviteteve, janë hartuar edhe planet paraprake të punës që i janë bashkangjitur këtij dokumenti, por edhe si dokument i veçantë. Planet e punës, objektivat dhe hartimi i politikave derivojnë edhe nga:

- Analizat e vazhdueshme e nevojave të AKSP-së;
- Analiza e nevojave dhe rekomandimet e institucioneve të sigurisë publike në Republikën e Kosovës;
- Rekomandimet dhe standardet nga raportet mbi vlerësimin e akreditimit vendor dhe ndërkombëtar të AKSP-së të hartuara në periudha të ndryshme kohore, të kryera nga AKA-ja, AKK-ja dhe IADLEST-i;
- Direktivat në nivel të Ministrisë apo të Qeverisë;
- Rekomandimet e partnerëve ndërkombëtarë.

2. Fushëveprimtaria e bashkëpunimit

Bazuar në misionin dhe vizionin e AKSP-së, fokusi kryesor i bashkëpunimit ndërkombëtar i AKSP-së është bashkëpunimi dhe rrjetëzimi me institucionet (akademitë) përkatëse ndërkombëtare të arsimit të lartë (duke përfshirë dhe hulumtimin) dhe trajnimit në fushën e sigurisë publike. Të gjitha qëllimet dhe objektivat e politikave për marrëdhënie me jashtë të AKSP-së mund të ndahen në tri kategori kryesore. Ato ngërthejnë në vete fushëveprimtarinë:

Akademike - Në fushën e bashkëpunimit akademik, me institucionet relevante të arsimit të lartë AKSP mëton të ngrisë më tutje aktivitetet si në vijim: hulumtimin e përbashkët me institucione të ngjashme si dhe me hulumtues të fushës përkatëse brenda dhe jashtë vendit, zhvillimin e kurrikulës përmes organizimit të punëtorive, seminarëve dhe takimeve tjera për këtë qëllim, si dhe shkëmbimin e studentëve, stafit akademik dhe atij administrativ në periudha të ndryshme kohore dhe në kuadër të mekanizma të ndryshëm shumëpalësh apo edhe të marrëveshjeve përkatëse dypalëshe.

Operacionale - Bashkëpunimi dhe aktivitetet e ndryshme të përbashkëta me institucione të ngjashme, mekanizma apo organizata të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, si ushtrime të përbashkëta apo protokolle apo procedura të përbashkëta për aspekte që kanë të bëjnë me nga aspekti i ngritjes së kapaciteteve në fushën e sigurisë publike.

Strategjike - AKSP është jashtëzakonisht e njohur brenda vendit dhe ndërkombëtarisht për pjesëmarrje në forume, konferenca, projekte dhe rrjete ndërkombëtare. Kjo realizohet përmes anëtarësimit të saj në rrjete dhe asociacione të ndryshme evropiane dhe ndërkombëtare të trajnimit dhe arsimit në siguri publike dhe zbatim të ligjit, anëtarë të të cilave janë institucionet (Akademitë) relevante të arsimit të lartë (duke përfshirë hulumtimin) dhe të trajnimit nga fusha e Sigurisë Publike. Këto rrjete dhe asociacione të ndryshme evropiane dhe ndërkombëtare janë: Agjencia e Bashkimit Evropian për Trajnim në Zbatim të Ligjit (CEPOL), Asociacioni i Kolegjeve Policore Evropiane (AEPC), Asociacioni Evropian i Kolegjeve të Shërbimit të Zjarrfikjes (EFSCA), Rrjeti Ndërkombëtar Frankofon i Trajnimit Policor (FRANCOPOL), Asociacioni Ndërkombëtar i Drejtorëve të Standardeve dhe Trajnimit të Zbatimit të Ligjit (IADLEST) dhe Asociacioni Ndërkombëtar i Akademive Policore (INTERPA).

3. Palët kyçe të interesit

Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) i ndan palët kyçe të interesit në dy kategori: palët e brendshme dhe të jashtme të interesit.

Në palë të brendshme të interesit bëjnë pjesë: Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), agjenci ekzekutive e të cilës edhe është AKSP-ja, si dhe institucionet e sigurisë publike, për të cilat AKSP dhe funksionon, siç janë: Policia e Kosovës, Inspektorati Policor i Kosovës dhe Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave, që i përkasin Ministrisë së Punëve të Brendshme; Shërbimi Korrektues i Kosovës dhe Shërbimi Sprovues i Kosovës që i përkasin Ministrisë së Drejtësisë dhe Dogana e Kosovës që i përket Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

Kurse palët e jashtme të interesit janë ministritë tjera të Qeverisë së Republikës së Kosovës, siç janë: Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), Ministria e Drejtësisë (MD) dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT); partnerët kryesorë ndërkombëtarë, siç janë: Misioni në Kosovë i OSBE-së, i cili dhe ka themeluar këtë institucion në vitin 1999, si dhe Programi i ICITAP në Kosovë i Departamentit të Drejtësisë së SHBA-ve, pastaj rrjetet dhe asociacionet ndërkombëtare, pjesë e të cilave është AKSP-ja, si: CEPOL, AEPC, EFSCA, FRANCOPOL, IADLEST dhe INTERPA, por natyrisht edhe të gjitha insitucionet e ngjashme, me të cilat AKSP ka marrëveshje formale bashkëpunimi, ose që bashkëpunon në baza të tjera dypalëshe joformale.

4. Parimet dhe standardet

Në fushëveprimtarinë e saj nga aspekti i bashkëpunimit vendor dhe ndërkombëtar, Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) është zotuar dhe ka përfillur gjithmonë parimet bazë për bashkëpunim. Ato parime do të sqarohen në vijim:

Reciprociteti dhe përfitimi i dyanshëm - Në çdo dakordim për bashkëpunim, qoftë formal apo joformal, me çfarëdo institucioni, mekanizmi, rrjeti apo asociacioni, AKSP ka parasysh përfitimet që do të jenë për zhvillimin e gjithëmbarshtëm të saj, por natyrisht edhe kontributin e saj për të avancuar dhe zhvilluar aspekte të ndryshme me atë subjekt me të cilin bashkëpunon.

Integriteti akademik dhe neutraliteti operacional - I gjithë produkti i bashkëpunimit që mund të jetë si rezultat i ndonjë marrëveshjeje formale apo joformale të bashkëpunimit apo ndonjë projekti vendor apo ndërkombëtar ku është e përfshirë AKSP-ja, duhet të plotësojë në mënyrë strikte standardet dhe kriteret më të avancuara ndërkombëtare sa i përket integritetit akademik.

Pajtueshmëria me legjislacionin kombëtar dhe obligimet ndërkombëtare - Secili dakordim për çfarëdo lloj bashkëpunimi ndërmjet AKSP-së dhe cilitdo institucion apo mekanizëm tjetër vendor apo ndërkombëtar realizohet duke respektuar në mënyrë të detajuar si legjislacionin ndërkombëtar, po ashtu edhe obligimet ndërkombëtare. Një pjesë e legjislacionit, të cilin AKSP gjithnjë e shqyrton dhe e ka parasysh në rastet e këtill është i përshkruar në vijim:

- Ligji nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike,
- Ligji nr. 04/L-052 për marrëveshjet ndërkombëtare,
- Ligji nr.03/L-132 për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës,
- Ligji nr. 06/L- 026 për azil,
- Rregullore nr. 38/2012 për planifikimin e trajnimeve dhe koordinimin e donacioneve për trajnimet e institucioneve të sigurisë publike të cilat organizohen dhe mbahen në AKSP,
- Rregullore (QRK) nr. 05/2019 për arsimin e lartë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike,
- Rregullore (AKSP) - nr. 01/2021 - për mobilitetin, trajnimet, studimet dhe vizitat studimore të studentëve etj.

Respektim i të drejtave të njeriut, vlerave demokratike dhe zbatimit të ligjit - Që nga themelimi i saj e deri më tani, AKSP është e njohur që zbaton në përpikmëri të gjitha vlerat, normat dhe standardet më bashkëkohore të respektimit të të drejtave të njeriut, vlerave demokratike dhe zbatimit të ligjit.

5. Llojet e aktiviteteve

Në kuadër të fushës së bashkëpunimit ndërkombëtar dhe marrëdhënieve me jashtë, në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) zhvillohen këto lloje të aktiviteteve:

Memorandume Mirëkuptimi (MM) / Marrëveshje bashkëpunimi - Lloji i njërës nga to varet nga fusha dhe niveli i bashkëpunimit dhe qëndrimit të institucionit, mekanizmit apo asociacionit partner.

Shkëmbimi i studentëve, stafit akademik dhe atij administrativ - Shkëmbimi i kategorive të sapopërmendura kryesisht realizohet në dy forma: përmes programeve ndërkombëtare që kanë si pjesë të aktivitetit të tyre këtë fushë, siç është p.sh. Programi Erasmus+ i Bashkimit Evropian, apo në baza dypalëshe si rezultat qoftë i ndonjë marrëveshjeje bashkëpunimi apo dakordimi paraprak përmes komunikimit formal me ndonjë institucion, mekanizëm apo asociacion partner.

Programe të përbashkëta trajnimi, ngjarje të ndryshme ose ushtrime simulimi (praktikë) - Në bashkëpunim me institucionet vendore, partnerët ndërkombëtarë të pranishëm në Kosovë, por edhe partnerët jashtë vendit, qofshin ata organizata ndërkombëtare, institucione të ngjashme apo rrjete a asociacione, AKSP ofron dhe realizon programe të përbashkëta të trajnimit, ngjarje të ndryshme të karakterit vetëdijësues, trajnues, akademik apo hulumtues në fushën e sigurisë publike.

Projekte ndërkombëtare (p.sh. Erasmus+, IPA, Horizon Europe) - AKSP përfshihet edhe në projekte të ndryshme ndërkombëtare, qoftë drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë përmes hisedarëve apo partnerëve të saj brenda apo jashtë shtetit, në projekte të ndryshme ndërkombëtare, që kanë për qëllim ngritjen e kapaciteteve të institucioneve të sigurisë publike qoftë në Kosovë apo jashtë saj.

Bashkëpunim në hulumtimin e temave që kanë të bëjnë me sigurinë publike - Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) është e përkushtuar që të zhvillojë bashkëpunim në fushën e hulumtimit në siguri publike. Kjo përfshin të gjitha lëmitë e sigurisë publike, të cilat AKSP i mbulon, siç janë: policia, korrektuesja, sprovuesja, dogana, mbikëqyrja policore, menaxhimi emergjent dhe zjarrfikja.

Pjesëmarrja në konferenca ose ngjarje të tjera ndërkombëtare - AKSP ka mandatin ligjor që të përfaqësojë Kosovën në të gjitha ngjarjet apo mekanizmat e karakterit ndërkombëtar, si konferenca shkencore apo profesionale ndërkombëtare, seminare, punëtori, grupe punuese etj., në të cilat flitet për aspektin e ngritjes së kapaciteteve, përkatësisht trajnimin, arsimin e lartë apo hulumtimin në fushën e sigurisë publike dhe zbatimit të ligjit.

6. Zhvillimi i partneritetit

Në këtë pjesë flitet se si Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) i inicon, vlerëson dhe mirëmban partneritetet me të gjithë mekanizmat brenda dhe jashtë vendit me të cilët bashkëpunon.

Inicimi i bashkëpunimit me ndonjë institucion, mekanizëm, rrjet apo asociacion ndërkombëtar vie si rezultat i komunikimit formal apo joformal të përfaqësuesve të AKSP dhe atyre nga subjektet partnere. Në raste të veçanta, inicimi mund të ndodh edhe nga miqtë dhe partnerët ndërkombëtarë të AKSP-së, institucionet e ndryshme të Republikës së Kosovës, kryesisht ato qeveritare, por edhe nga përfaqësitë diplomatike të Republikës së Kosovës jashtë vendit apo ato të shteteve të tjera të pranishme në Republikën e Kosovës.

Në përzgjedhjen e partnerëve rol të rëndësishëm luan se çfarë mund të përfitojë AKSP-ja, institucionet e sigurisë publike të Kosovës apo edhe vet shteti nga një bashkëpunim apo partner i veçantë, por edhe se sa dhe çfarë kontributi mund të japë AKSPja për një bashkëpunim me ndonjë subjekt të caktuar.

Në rastin e lidhjes së marrëveshjeve me mekanizma jashtë shtetit, si parim, në bazë të Nenit 12 të Ligjit nr. 04/L-052 për marrëveshjet ndërkombëtare, Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) përmes Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) i dërgon Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD) draft tekstin e marrëveshjes për shqyrtim. Me të marrë pëlqimin nga MPJD përmes MPB-së, AKSP vazhdon komunikimin me institucionin, mekanizmin, rrjetin apo asociacionin ndërkombëtar për tu dakorduar lidhur me vendin dhe datën e ceremonisë së nënshkrimit të Marrëveshjes së bashkëpunimit ose Memorandumit të mirëkuptimit. Kurse me rastin e lidhjes së marrëveshjeve me mekanizma brenda shtetit, mjafton dakordimi paraprak i AKSP-së dhe mekanizmit, përkatësisht mekanizmave përkatës, me ç'rast dhe vie deri te nënshkrimi i marrëveshjeve dypalëshe, përkatësisht shumëpalëshe.

AKSP sistematikisht bën çdo vit rishikimin dhe bilancin e marrëveshjeve të nënshkruara, përkatësisht shqyrtimin e marrëveshjeve joformale, duke i veçuar sukseset, rezultatet, sfidat dhe dështimet. Në bazë të këtyre vlerësimeve bëhen edhe rekomandimet përkatëse për intensifikimin, përkatësisht fushat specifike në të cilat vendoset që të bashkëpunohet në periodat e ardhshme kohore me ndonjë subjekt të veçantë, qoftë institucion, mekanizëm, rrjet apo asociacion.

7. Përgjegjësitë institucionale

Akademia (AKSP) sipas ligjit Nr. 04/L-053 është përgjegjëse për ofrimin e trajnimeve dhe arsimit të lartë (duke përfshirë hulumtimin) si dhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike për të gjitha institucionet e sigurisë publike në Republikën e Kosovës, por pa u kufizuar vetëm në: Policinë e Kosovës, Shërbimin Korrektues të Kosovës, Shërbimin Sprovues të Kosovës, Doganën e Kosovës, Agjencinë e Menaxhimit Emergjent (ku përfshihen zjarrëfikësit) dhe Inspektoratin Policor të Kosovës.

Divizioni për Marrëdhënie me Jashtë (DMJ) luan rol vendimtar në promovimin e vlerave dhe të arriturave të institucionit në nivel vendor dhe ndërkombëtar, në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe institucionale si dhe në shkëmbimin e përvojave dhe njohurive më të mira përmes bashkëpunimit ndërkombëtar. Në këtë kontekst, fushat kryesore ndërvepruese për të cilat është përgjegjëse ky Divizion janë si në vijim:

- Zhvillimi dhe mbikëqyrja e bashkëpunimit dhe marrëdhënieve ndërkombëtare (rrjetëzimi, shkëmbimi i informacionit, luajtja e rolit të pikës së kontaktit dhe përfaqësimit ndërkombëtar për AKSP-në),
- Zhvillimi i politikave në kuadër të marrëdhënieve me jashtë,
- udhëheqja, kordinimi dhe menaxhimi e programeve, projekteve dhe donacioneve të ndryshme, në emër dhe në llogari të AKSP-së
- Përkrahja dhe pjesëmarrja në procese dhe aktivitete nga fusha e trajnimeve, arsimit të lartë dhe hulumtimit në kuadër të fushëveprimtarisë së DMJ-së dhe
- Koordinimin e vizitave ose delegacioneve ndërkombëtare që e vizitojnë AKSP-në ose që janë të interesuar për të.

Ngritja e kapaciteteve profesionale dhe institucionale në të gjitha aspektet, e me theks të veçantë trajnimi dhe arsimimi i zbatuesve të ligjit si faktor kyç në ngritjen e sigurisë publike, është sfidë shumëdimensionale. Prandaj, bashkëpunimi me të gjithë aktorët relevantë vendorë dhe ndërkombëtarë brenda dhe jashtë vendit në fushën e arsimit në siguri publike është thelbësor për të adresuar në vazhdimësi dhe me kohë të sfidave aktuale dhe për të siguruar që të gjithë aktorët relevantë, respektivisht vijuesit e trajnimeve, studentët, profesionistët, stafi i Akademisë dhe i palëve të interesit (të ISP-ve) që përmes trajnimeve dhe studimeve të marrin njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë e duhura me cilësi të lartë dhe sipas standardeve më të larta (të krahasueshme dhe të njohura ndërkombëtarisht).


8. Financimi dhe burimet

Në kuadër të buxhetit që Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) ndan për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP), në të janë përcaktuar edhe shpenzimet (të emërtuara sipas termave zyrtar financiar) mire që përfshihen shpenzimet nga fusha e marrëdhënieve me jashtë dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, të cilat kryesisht menaxhohen në kordinim me Divizionin për Marrëdhënie me Jashtë (DMJ). Për më tepër, në rastin e bashkëpunimit të AKSP-së me mekanizma të ndryshëm të jashtëm, aktivitetet që targetojnë bashkëpunimin ndërkombëtar mund të mbulohen financiarisht edhe nga burime të ndryshme të financimit të jashtëm (p.sh. fondet e BE-së, donatorët/mekanizmat e ndryshëm ndërkombëtarë, siç janë OSBE, ICITAP, Fullbright Specialist, etj.). Përveç këtyre dy formave, financimi dhe burimet përkatëse financiare për aktivitetet e lartpërmendura të AKSP-së apo që ndërliken me të mund të jenë edhe të natyrës së përzier, që nënkupton se sipas dakordimit paraprak bëhet ndarja e kostove ndërmjet AKSP-së dhe institucioneve apo mekanizmave partnerë.

9. Monitorimi, vlerësimi dhe raportimi

Në monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e politikave të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe marrëdhënieve me jashtë në kuadër të AKSP-së, është thelbësore që t'i jepet përparësi komunikimit të qartë, bashkëpunimit dhe respektimit të protokolleve të vendosura e të ndërsjellta. Kjo përfshin qëllimet dhe objektivat e qarta të vendosura, sigurimin e koordinimit dhe bashkëpunimit efektiv midis palëve të interesit dhe monitorimin e rregullt periodik të progresit drejt qëllimeve të përcaktuara.

Vlerësimi bazohet në rezultate të matshme dhe informata kthyes nga të gjitha palët e përfshira për të vlerësuar efektivitetin e nismave të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe marrëdhënieve me jashtë. Në këtë mënyrë, disa prej elementëve të cilët maten për çdo vit nga njësia përgjegjëse, pra Divizioni për Marrëdhënie me Jashtë (DMJ), janë numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit / memorandumeve të mirëkuptimit të nënshkruara, numri i shkëmbimit të studentëve, pjesëtarëve të stafit akademik apo atij administrativ, si dhe numri i projekteve në të cilat AKSP është përfshirë apo ka bërë hapa konkretë që garantojnë përfshirjes e saj në vitin vijues. Për më tepër, përmirësimi i vazhdueshëm përmes shkëmbimit të njohurive dhe ekspertizave, si dhe përshtatja e bazuar në praktikën më të mira janë thelbësore për zbatimin e suksesshëm të qëllimeve dhe objektivave, respektivisht të politikave të përcaktuara.



10. Menaxhimi i riskut

Politikat e bashkëpunimit ndërkombëtar në institucionet trajnuese dhe të arsimit të lartë në fushën e sigurisë publike janë një komponent thelbësor për përballimin efektiv të sfidave globale të sigurisë. Një kuadër i qartë politikash dhe procedurash që adreson ndjeshmëritë politike, sigurinë e të dhënave, dhe kornizat ligjore do të sigurojë një bashkëpunim të qëndrueshëm, transparent dhe të besueshëm mes partnerëve ndërkombëtarë. Përmes menaxhimit efektiv të rreziqeve, këto institucione do të kontribuojnë në ngritjen e vazhdueshme dhe të qëndrueshme të kapaciteteve profesionale dhe në forcimin e sigurisë kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare apo globale.

Rreziqet e mundshme dhe menaxhimi i tyre

Ndër rreziqet parësore të mundshme mund të jenë si në vijim:

- Ndjeshmëria politike,
- Korniza ligjore për bashkëpunim ndërkombëtar,
- Mbrojtja e të dhënave dhe konfidencialiteti.

a) Ndjeshmëria politike

Në fushën e sigurisë publike, bashkëpunimi ndërkombëtar përballet me sfida të veçanta për shkak të natyrës së ndjeshme të informacionit dhe interesave kombëtare që mund të jenë në konflikt. Ndjeshmëria politike përfshin mosbesimin mes vendeve, ndryshimet në politikën e jashtme, apo tensionet rajonale që mund të ndikojnë në marrëdhëniet institucionale.

Menaxhimi i rrezikut:

- Zbatimi i një kuadri të qartë diplomatik dhe protokolleve të komunikimit, për të shmangur keqkuptimet dhe konfliktet.
- Konsultime të rregullta me autoritetet respektive vendore (kombëtare) dhe ndërkombëtare për të përcaktuar kufijtë dhe fushat e bashkëpunimit dhe të komunikimit.
- Trajnimin e stafit për ndjeshmëritë politike dhe për menaxhimin e situatave delikate (të ndjeshme).
- Krijimi i mekanizmave që menaxhojnë situatat e tilla të ndjeshme (ndërmjetësojnë) dhe gjejnë zgjidhje.

b) Korniza ligjore për bashkëpunim ndërkombëtar

Çështjet ligjore janë thelbësore për të siguruar një bashkëpunim të rregullt dhe efektiv mes institucioneve nga vende të ndryshme. Çdo vend ka ligjet e veta që rregullojnë trajtimin e informacionit, mbrojtjen e të dhënave, dhe mënyrën e bashkëpunimit me institucione të huaja. Pa një kuadër ligjor të qartë, rreziku i moskuptimit dhe konflikteve ligjore është i lartë.

Menaxhimi i rrezikut:

- Hartimi i marrëveshjeve ndërinstitucionale që respektojnë legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Përdorimi i konsulencës ligjore për të përcaktuar rregullat dhe përgjegjësitë e secilës palë.
- Përcaktimi i procedurave të qarta për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ligjore.
- Ndjekja e rekomandimeve dhe standarteve të organizatave ndërkombëtare (p.sh., BE, Interpol, OSBE) në fushën e sigurisë dhe arsimit.
- Përditësimi i vazhdueshëm i politikave për të qenë në harmoni me ndryshimet ligjore dhe teknologjike.

c) Mbrojtja dhe konfidencialiteti i të dhënave

Institucionet e arsimit dhe trajnimit në fushën e sigurisë publike mbledhin dhe trajtojnë të dhëna shumë të ndjeshme që mund të përfshijnë informacione personale, strategjike, apo operacionale. Rreziku i zbulimit të këtyre të dhënave mund të rrezikojë sigurinë e individëve dhe të vetë bashkëpunimeve.

Menaxhimi i rrezikut:

- Implementimi i standardeve më të larta të sigurisë kibernetike dhe të teknologjisë së informacionit.
- Përcaktimi i politikave të qarta për qasjen dhe përdorimin e të dhënave, përfshirë mekanizma të kontrollit dhe mbikëqyrjes.
- Nënshkrimi i marrëveshjeve të konfidencialitetit mes partnerëve të bashkëpunimit. Trajtime të vazhdueshme për personelin mbi rregullat e mbrojtjes së të dhënave dhe rreziqet e sigurisë.

11. Komunikimi dhe dukshmëria

Aktivitetet që zhvillohen nga fusha e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe marrëdhënieve me jashtë zënë vend të rëndësishëm në të gjitha platformat elektronike në të cilat është e dukshme AKSP-ja. Kështu, çdo aktivitet i këtij lloji promovohet përmes mënyrave të ndryshme, siç janë: përdorimi i mediave përmes zyrtarit të lartë përkatës që Akademia e ka të punësuar për këtë fushë, postimi në faqen e internetit si dhe në rrjetet sociale që aktualisht posed Akademia, por edhe përmes publikimeve të ndryshëm të artikujve në gazeta, revista, faqe internet apo profile të rrjeteve sociale të partnerëve ndërkombëtarë të saj.

Përveç kësaj, prania, reputacioni dhe kontributi i AKSP-së në aspektin ndërkombëtar bëhet e mundshme në masë të madhe edhe përmes pjesëmarrjes së saj në takime të rregullta dhe të veçanta të rrjeteve dhe asociacioneve të përmendura më lart në këtë dokument, anëtare e të cilave është. Po ashtu, një gjë e tillë arrihet edhe përmes vizitave dhe qëndrimeve të ndryshme brenda dhe jashtë shtetit të përfaqësuesve të niveleve të ndryshme të Akademisë tek partnerët e saj institucionalë jashtë shtetit apo të palëve të interesit dhe partnerëve brenda shtetit, por edhe me rastin e vizitave dhe qëndrimeve në AKSP të përfaqësuesve të të gjitha këtyre subjekteve të lartpërmendura.

12. Përputhshmëria me strategjitë kombëtare dhe ndërkombëtare

Në aspektin strategjik, këto politika të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe marrëdhënieve me jashtë të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike (AKSP) janë në përputhje të plota me dokumentet e tjera të kësaj natyre në nivel më të lartë se kjo, të cilat janë:

- Strategjia Zhvillimore dhe Plani i Veprimit AKSP 2023 - 2026;
- Strategjia e Arsimit të Kosovës dhe Plani i Veprimit 2022 - 2026;
- Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021 - 2025.

Në ‘Strategjinë Zhvillimore dhe Planin e Veprimit AKSP 2023 – 2026’, pjesë e **Objektivit strategjik 6** “Fuqizimi i bashkëpunimit vendor dhe ndërkombëtar si dhe rritja e kredibilitetit të AKSP” janë dy objektiva specifikë, përkatësisht:

6.1. Ndërtimi dhe avancimi i partneriteteve me institucione vendore dhe ndërkombëtare, dhe

6.2. Rritja e kredibilitetit përmes transparencës dhe besueshmërisë.

Te ‘Strategjia e Arsimit të Kosovës dhe Plani i Veprimit 2022 - 2026’ ceket se njëri ndër objektivat specifikë është si në vijim: Objektivi specifik 4.4: Ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë përmes programeve të përbashkëta të studimit, rritjes së pjesëmarrjes në programe ndërkombëtare të bashkëpunimit akademik dhe shkencor si dhe integritetit në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë.

Kurse te ‘Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021 – 2025’, pjesë të nënkapitullit 2.3. Rendi dhe siguria publike janë: 2.3.1 Parandalimi dhe luftimi i krimit, 2.3.2 Rritja dhe ruajtja e sigurisë publike dhe 2.3.3 Forcimi i integritetit të institucioneve të rendit dhe sigurisë; pjesë të nënkapitullit 2.15 Arsimi dhe shkenca është edhe 2.15.4 Arsim i lartë me cilësi dhe integritetit, në harmoni me standardet ndërkombëtare; kurse tek nënkapitulli 2.17 Politika e jashtme dhe diaspora, pjesë të saj janë edhe: 2.17.1 Shtet ligjor demokratik me synim integritimin në BE dhe NATO dhe 2.17.2 Thellimi i bashkëpunimit me vendet me interes strategjik dhe marrëdhënieve dypalëshe.

13. Tabela për detajet e rishikimit të politikave të bashkëpunimit dhe marrëdhënieve me jashtë

Nr.	Data e rishikimit	Qëllimi i rishikimit	Aspektet për rishikim	Komentet & përmirësimet	Aprovuar nga:

SHTOJCAT

14. Përcaktimi i objektivave të planit të punës së DMJ-së

Divizioni për Marrëdhënie me Jashtë (DMJ) / Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP)

Nr.	OBJEKTIVI	AKTIVITETI
1	Shkëmbimi i përvojave me institucione të ndryshme ndërkombëtare përmes programeve të shkëmbimeve	- Shfrytëzimi i mundësive të ofruara nga projektet / programet nga fondet e BE-së (ERASMUS+, CEPOL, TAIEK, etj), fondet e SHBA-së (INL, Fulbright, etj.) - Shfrytëzimi i mundësive të ofruara nga programet bilaterale dhe multilaterale - Promovimi dhe inkurajimi i personelit dhe zyrtarëve të sigurisë publike për pjesëmarrje në programe dhe projekte të ndryshme
2	Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione vendore dhe ndërkombëtare	- Nënshkrimi i marrëveshjes me institucionet që tashmë jemi në proces e sipër - Nismat e ndërmarra dhe realizimi i vazhdimit të marrëveshjeve që do të ju skadojë afati në një të ardhme të afërt - Nismat e ndërmarra dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të reja
3	Identifikimi i partnerëve vendorë dhe ndërkombëtarë si dhe adresimi i kërkesave për mbështetje	- Identifikimi i donatorëve potencialë (vendorë dhe ndërkombëtarë) - Përgatitja e kërkesave nga njësitë kërkuuese - Kërkesat e hartuara dhe të adresuara - Marrja e informatave kthyes (feedback) nga akterët e përfshirë me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të procesit të realizimit të kërkesave (nevojave)
4	Realizimi i bashkëpunimit nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme me institucione vendore dhe ndërkombëtare në kuadër të fushëveprimtarisë së trajnimeve, arsimit të lartë dhe hulumtimit	- Aktivitetet e realizuara të AKSP-së dhe ISP-ve - Vizitat e pranuar nga institucionet e jashtme vendore dhe ndërkombëtare dhe organizimi i ngjarjeve dhe aktiviteteve në interes të përbashkët
5	Vazhdimi i bashkëpunimit me institucionet me të cilat AKSP ka marrëveshje	- Marrëveshjet e nënshkruara - Aktivitetet e realizuara

15. Plani i veprimit për 2024

Divizioni për Marrëdhënie me Jashtë (DMJ) / Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP)

Ky plan i veprimit derivon nga plani i punës së DMJ-së për vitin 2024. Me qëllim të zbërthimit të mëtutjeshëm dhe të thjeshtimit të kuptueshmërisë së tij, paraqitet në formën tabelare si në vijim:

Nr.	Objektivat e DMJ-së	Aktivitetet		Afati kohor	Kosto financiare	Treguesi i matjes	Njësitë përgjegjëse/mbështetese	Ndërlidhja me dokumente e tjera
7	Fuqizimi i bashkëpunimit vendor dhe ndërkombëtar	7.1	Identifikimi i partnerëve vendorë dhe ndërkombëtarë si dhe adresimi i kërkesave për mbështetje	K1-K4	Kosto administrative	- Partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë të identifikuar për mbështetje - Kërkesat e hartuara dhe adresuara	DMJ (të gjitha njësitë)	Plani Strategjik dhe Operacional i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025 Raportet e vlerësimit akreditues të AKK, AAK dhe IADLEST
		7.2	Nënshkrimi i marrëveshjeve vendore dhe ndërkombëtare	K1-K4	Kosto administrative	- Marrëveshjet e nënshkruara me institucionet e reja	DMJ (DPSÇL)	
		7.3	Vazhdimi i bashkëpunimit me institucionet me të cilat AKSP ka marrëveshje	K1-K4	Kosto administrative	- Marrëveshjet e nënshkruara - Aktivitetet e realizuara	DMJ (DPSÇL)	
		7.4	Identifikimi dhe shfrytëzimi i programeve të këmbimit (CEPOL, ERASMUS+, Fullbright etj.)	K1-K4	Donacion	- Aktivitetet e realizuara	DMJ (AKSP, ISP)	
		7.5	Promovimi dhe inkurajimi i personelit dhe zyrtarëve të sigurisë publike për pjesëmarrje në programe të mobilitetit	K1-K4	Kosto administrative	- Materialet promovuese të shpërndara - Aktivitetet e realizuara	DMJ	
		7.6	Hartimi i kërkesave për mbështetje nga donatorët dhe identifikimi i donatorëve të mundshëm	K1-K4	Kosto administrative	- Kërkesat e hartuara - Adresimi i kërkesave	DMJ (të gjitha njësitë)	Direktivat e MPB